



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:274167

Datë: 26.02.2024

Numri i dokumentit: 05373954

AA.nr.563/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Besarta Sopaj, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.R nga Ferizaj, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.670/2019 të datës 03.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit N.R nga Ferizaj, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.670/2019 i datës 03.07.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.670/2019 të datës 03.07.2023, është refuzuar si e pa bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit N.R nga Ferizaj, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve i Republikës së Kosovës me nr.të dosjes 5020742 të dt. 16.12.2016.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, për shkak të: konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovon si të bazuar ankesën e paditësit dhe aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë ta prishe dhe ta kthejë çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje ose të njëjtin ta ndryshoj dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovtoj si të bazuar .

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 par.1 të Ligjit për Konfliktet

Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Pensioneve i Republikës së Kosovës në Prishtinë, me vendimin me numër të dosjes 5020742 të dt. 16.12.2016, e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e N.R , me numër ID-së ..., për njohjen e të drejtës në Pensionin të Personave me Paaftësi të Përhershme.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 20.03.2019, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, si dhe dokumentacionit dhe shkresave tjera të lëndës bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë. Me arsyetim se nga provat relevante të cilat u administruan, gjykata e shkallës së parë vërejtë dhe atë nga: Vlerësimi Komisioni Mjekësor i dt.29.07.2014, se paditësi i ishte refuzuar e kërkesa lidhur me të drejtën në pension e personave me paaftësi të përhershme. Më pas kjo kërkesë ishte refuzuar, bazuar në vlerësimin e dt.16.11.2014, edhe nga komision mjekësor që kishte vepruar në shqyrtim të ankesës, si dhe nga komisioni përkatës për shqyrtimin e lëndës pas aktgjykimit, vlerësim ky i datës 24.11.2016. Ku që të gjitha këto komisione kompetente të përcaktuara nga e paditura kishin pasur parasysh dhe shqyrtuar gjithë dokumentacionin mjekësor të parashtruar nga paditësi. Gjykata, e shkallës së parë në të mirë të vërtetimit të gjendjes faktike dhe duke pasur parasysh Akvendimin e Gjyaktës së Apelit AA.nr.950/2021 të datës 18.07.2022 sipas detyrës zyrtare kishte caktuar edhe nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore, e cila i është besuar ekspertëve të SHSKUK, dr. A.B-kardilog, B.P-okuliste dhe Z.L-otorolog, e të cilët kishin dorëzuar gjykatës ekspertizën e kërkuar me datë 05.04.2023. Gjykata e shkallës së parë shqyrtoi ekspertizën e përpiluar nga këta ekspertë dhe pati parasysh deklaratat e dr. A.B dhe Z.L të dhëna para kësaj gjykate, dhe përmes vërejtjes se të njëjtit kishin konstatuar se për periudhën e datës 30.06.2014 deri më datë 27.06.2016 në shkresat e lëndës nuk kishin gjetur dokumentacion të mjaftueshëm për të ardhur në një përfundim që te paditësi ka ekzistuar kjo paaftësi. Kështu marr parasysh vlerësimet e komisioneve mjekësore, kompetente të përcaktuara nga e paditura, ekspertizën mjekësore të datës 05.04.2023 si dhe sqarimet shtesë të dhëna në seancën nga ana e ekspertëve mjekësor është vërtetuar qartë nga gjykata se paditësi nuk përmbush kushtet ligjore për të qenë shfrytëzues i këtij pensioni.

Prandaj me që paditësi nuk kishte ofruar dëshmi tjera dhe të mjaftueshme mjekësore që do të vërtetonin se i njëjti kishte paaftësinë e plotë dhe të përhershme, kusht ky ligjor, për njohjen e të drejtës në pensionin e Personave me Aftësi të Kufizuar, i përcaktuar nga Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht nenit 9, paragrafi 5, gjykata e shkallës së parë vlerësoi se e paditura drejtë ka konstatuar gjendjen faktike, drejta ka aplikuar të drejtën materiale dhe ligjin procedural kur ka refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar, dhe mbi këto arsye aktvendimi kontestues i të paditurës vlerësohet i drejtë dhe i ligjshëm. Gjykata e shkallës së parë vlerësoi edhe pretendimet e paditësit të parashtruara në padi dhe në seancën e shqyrtimit kryesor dhe të njëjtat i refuzoi si të pabazuara, sepse me provat e administruara, në kuptim të dispozitës së nenit 9 Ligjit nr.04/L-131 për

Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, është vërtetuar se i njëjti nuk i plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së kërkuar.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpapia e paditësit është e pa bazuar.

Përkundër se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, kolegji i kësaj gjykate të njëjtin e ka shikuar sipas detyrës zyrtare sa i përket kësaj baze ankimore, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se sikur gjykata e shkallës së parë kishte me i pranuar nga paditësi provat të cilit paditësi kishte kërkuar nga gjykata që ti pranoje dhe ti shqyrtoj atëherë edhe komisioni i eksperteve kishte me konstatua paaftësinë e paditësit. Provat të cilat i ka pas dhe nëse gjykata e kthen në rishqyrtim këtë çështje administrative do ti prezantoje dhe do ti arsyetoj si, trajtimi në Stanboll Dr.G.E, raportet dhe konstatimet nga poliklinika "A..." me kirurg Dr A.C raportet mjeksore nga K..., analizat laboratorike nga T... Lab dhe V... Lab, fletshlimet nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës. Nga të gjitha këto deshmi me siguri edhe grupi i eksperteve kish me dhane mendimin e vete profesional, e jo te deklarohet se nuk kane qene të mjaftueshme provat dhe shkresat e landës. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate vlerëson se janë të pabazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe ekspertiza nga institucioni i QKUK-së e datës 05.04.2023, si dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ i të paditurës është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Nga provat e administruara rezulton se me konstatimin dhe mendimin e Komisionit Mjekësor është konstatuar se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme mjekësore për të qenë përfitues i Pensionit për Personat me Paaftësi të Përhershme. Andaj gjykata e shkallës së parë me qëllim të vendosjes së çështjes në mënyrë meritore, me të drejtë ka marr aktvendim për nxjerrjen e provës me ekspertizë nga institucioni i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, të cilët kanë konstatuar se paditësi nuk përmbush kushtet ligjore për të qenë shfrytëzuese e këtij pensioni. Prandaj, konform Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, i cili përcakton kriteret për përfitimin e të drejtës në Pension për Persona me Aftësi të Kufizuar, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se paditësi nuk i plotëson kushtet për njohjen e të drejtës për pension të personave me aftësi të kufizuar bazuar në Ligjin e lartcekur. Prandaj, nga këto arsye kolegji i kësaj gjykate vlerëson se aktgjykimi i ankimuar është i drejtë dhe i bazuar, se ka mbështetje në provat e administruara dhe se janë dhënë arsye të mjaftueshme nga gjykata e shkallës së parë, të cilat edhe kolegji i kësaj gjykate i pranon.

Kurse sa i përket pretendimeve tjera ankimore se gjykata e shkallës së parë ka pasur mundësi te shtyje seancën dhe te caktojë një seance te re më të cilën me ane te ftesës do ta njoftonte paditësin dhe se gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale. Kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pabazuara të paqëndrueshme dhe të paargumentuara me prova konkrete të cilat do të gjenin mbështetje ligjore dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.563/2023 me datë 14.02.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi